



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.A.nr.49/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bardiqi - kryesues, Hidajete Gashi Alaj dhe Kujtim Pasuli - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), paraqitur kundër subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për shkak të shkeljeve Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, në ditën e votimit, në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 28 Dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 30.12.2025, merr këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET Pjesërisht e bazuar ankesa ZP.Anr.49/2025 e datës 28.12.2025, për shkak përdorimit të fëmijëve në fushatë zgjedhore Rasti 1, dhe për shkak të thyerjes të heshtjes zgjedhore në ditën e votimit dhe atë, për Rastin 3, 5, 6 dhe 9 te përshkruara në ankese, të paraqitur nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 28 Dhjetor 2025.

II. Subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, në ditën e votimit, në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 4500€ (katërmijë e pesëqind euro).

III. REFUZOHET Pjesërisht e pabazuar ankesa ZP.Anr.49/2025, e datës 28.12.2025, për shkak të shfrytëzimit të pjesëtareve të Forcës së Sigurisë së Kosovës gjatë fushatës zgjedhore, Rasti 2, dhe për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore në ditën e votimit dhe atë, për Rastin 4, 7 dhe 8 te përshkruara në ankese, e paraqitur nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 28 Dhjetor 2025.

A r s y e t i m

Me datën 28.12.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), në të cilën pretendon aktivistët e saj kanë vërejtur se në tubimin përmbyllës të LVV-së në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve-në sallën e djegur, janë përdorur fëmijët nën moshën 15

vjeçare për fushatë zgjedhore të cilat shihen në skenë së bashku me kandidatin për deputet Albin Kurti, duke bërë shkelje të nenit 5 paragrafit 3 të Rregullores Zgjedhore nr.07/2024. Në rastin e dytë kanë vërejtur një postim në të cilën shihet një video e Forcës së Sigurisë së Kosovës, në rrjetin social facebook kandidati për deputet nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje- Ilir Qeriqi, të bërë në ditën e votimit duke e shkelur dispozitën e nenit 5 paragrafi 2 në paragrafi 2.2 të Rregullores Zgjedhore nr. 07/2024. Në rastin e tretë aktivistët e Lidhjes Demokratike të Kosovës kanë vërejtur se në ditën e zgjedhjeve ku ka edhe heshtje zgjedhore, është thyer heshtja zgjedhore në një rast në Peje ku afër qendrës së votimit Sami Frashëri në fshatin Ozdrim ka qëndruar një makinë me flamur me elemente zgjedhore të subjektit politik LVV. Në rastin e katërt aktivistët e LDK-së kanë vërejtur se ditën e zgjedhjeve është thyer heshtja zgjedhore, ku në Hajvali një autobus ka qëndruar pranë qendrës së votimit Shkëndija me elemente zgjedhore të subjektit politik LVV dhe kandidatin Albin Kurti. Në rastin e pestë aktivistët e LDK-së kanë vërejtur se në ditën e zgjedhjeve mbështetësi i Lëvizjes Vetëvendosje Drini Kastrati ka postuar në rrjetin social Facebook duke u bërë thirrje për votim për Lëvizjen Vetëvendosje dhe kandidatin për deputet Albert Selishta. Në rastin e gjashtë kanë vërejtur se mbështetësja e LVV-së Anita Ukaj ka postuar në rrjetin social facebook duke bërë thirrje për votim për Lëvizjen Vetëvendosje. Në rastin e shtatë kanë vërejtur se në ditën e zgjedhjeve kandidati për deputet me numër 54 Ejup Ahmeti ka statut aktiv të sponsorizuar të cilin nuk e ka deaktivizuar. Në rastin e tetë kanë vërejtur se në ditën e zgjedhjeve mbështetësi LVV-së Valdrin Gashi ka status aktiv të sponsorizuar të ciklin nuk e ka deaktivizuar. Në rastin e nëntë kanë vërejtur se ditën e zgjedhjeve mbështetësi i LVV-së Afrim Gashi ka postuar foto dhe status me shkrimin: “Unë votova 116 për SIGURI DHE BEGATI voto edhe ti urime”. Tutje kanë theksuar se në të gjitha këto raste janë shkelur dispozitat e Rregullores Zgjedhore nr.07/2024, duke kërkuar nga PZAP që të nxjerrë vendim përmes së cilës do ti dënojë me gjobë për secilën shkelje subjektin politik Lëvizja Vetëvendosje. Ankesës i kanë bashkangjitur CD dhe fotografi të postimeve.

Në përgjigje në ankesë subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) kane deklaruar se sa i përket rastit një në tubimin përmbyllës disa fëmijë janë ngjitur në skenë për ta përqaftuar kryeministrin në detyrë dhe për të bërë fotografi, gjë që ka ndodhur në mënyrë spontane, pa përgjegjësinë e subjektit, dhe nuk mund të konsiderohet si angazhim. Tutje kanë theksuar se marrë parasysh moshën shumë të re të fëmijëve është e pamundur që ata fëmijë të kenë qenë vetëm në tubim, pa praninë e prindërve të tyre, ashtu që kryeministri në detyrë kthehet nga prindërit dhe kërkon që ta fotografojnë. Në rastin e dytë kanë theksuar sa i përket postimit të Ilir Qeriqi, nuk ka të bëjë me përfshirje të pjesëtarëve të Forcave të Sigurisë së Kosovës sepse videoja është më e vjetër, e kohës kur kandidati në fjalë ishte pjesëtar i graduar i FSK-së. Tutje kanë theksuar se meqë kjo video nuk është bërë enkas për fushatë, por vetëm është shfrytëzuar material i arkivuar, nuk mund të bëhet argumenti se pjesëtar të FKS-së, janë përfshirë në fushatë. Në rastin e tretë theksojnë se pretendimet për thyerje të heshtjes zgjedhore janë të pabazuara, pasi që nga prania e automjetit që shihet në provë, në afërsi të qendrës së votimit nuk përben aktivitet zgjedhor aktiv, pasi nuk është dëshmuar se është bërë thirrje për votim, shpërndarje materiale apo komunikim politik me votuesit. Vendosja e flamurit apo elemneteve identifikuese, pa veprim të metëjshëm ndikues, nuk përmbush kriteret ligjore për konstatimin e shkeljes së heshtjes zgjedhore, theksojnë se ky automjet nuk

është në pronësi të subjektit politik LVV, dhe nuk është vendosur atë me direktiva të subjektit LVV. Në mungesë të pronësisë dhe vullnetit për ta kryer këtë veprim, subjekti LVV nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi ligjore për veprimet e palëve të treta. Në rastin e pestë kanë deklaruar se postimi në rrjetin social Facebook është bërë nga një profil privat, në profil personal, pa autorizim, koordinim apo kërkesë të subjektit politik ose kandidatit përkatës. Kanë shtuar se subjekti politik nuk mban përgjegjësi për shprehjet individuale të mbështetësve të tij, kur këto nuk përbëjnë aktivitet të organizuar apo të drejtpërdrejtë elektoral. Në mungesë të lidhjes institucionale apo organizative me subjektin politik nuk plotësohen kushtet për konstatimin e shkeljes. Në rastin e gjashtë e kundërshtojnë pretendimin për thyerjen e heshtjes zgjedhore për arsye se postimi i përmendur është bërë nga një mbështetës në profilin e saj personal dhe përmban shprehje emocionale dhe pa veprim konkret për ndikim në votues. Nuk mund të pretendohet se postimi është sponsorizuar, shpërndarë apo koordinuar nga LVV ose strukturat e saj, pra mungon elementi i veprimit elektoral aktiv për konstatimin e shkeljes së heshtjes zgjedhore. Në rastin e shtatë kanë deklaruar se e kundërshtojnë pretendimin e parashtruesit të ankesës, për arsye se materiali i sponsorizuar është iniciuar para fillimit të heshtjes zgjedhore dhe nuk ka pasur ndërhyrje të qëllimshme për ta mbajtur aktiv gjatë ditës së zgjedhjeve. Vonesat teknike në deaktivizimin e përmbajtjes në platformat digjitale nuk mund ti atribuohen automatikisht subjektit politik si shkelje në mungesë të provave për qëllim apo veprim aktiv gjatë heshtjes zgjedhore. Për pasojë, nuk ekzistojnë elemente të mjaftueshme për përgjegjësi ligjore. Në rastin e tetë i kundërshtojnë pretendimet e palës për arsye se statusi i sponsorizuar është iniciuar para fillimit të heshtjes zgjedhore dhe nuk ka pasur veprim aktiv apo vendimmarrje të re për ta mbajtur atë të aktivizuar gjatë ditës së zgjedhjeve. Tutje kanë shtuar se përmbajtja e sponsorizuar është postuar nga një individ privat, i cili vepron në cilësinë e përkrahësit dhe jo si përfaqësues apo strukturë zyrtare e LVV-së. Vazhdimi teknik i shfaqjes së përmbajtjes në platformën digjitale nuk përbën në vete veprim elektoral të qëllimshëm nga subjekti politik, në mungesë të provave për ndërhyrje, koordinim apo autorizim institucional gjatë heshtjes zgjedhore. Në rastin e nëntë pretendimi për thyerje të heshtjes zgjedhore është i pabazuar, pasi që postimi është bërë nga një individ privat, në profilin e tij personal, pa ushtrim të së drejtës së votës, dhe përmban shprehje individuale të bindjes personale, pa karakter organizativ apo ndikim të drejtpërdrejtë elektoral.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës - PZAP-i, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, si dhe përgjigjes në ankesë, gjeti se:

-Ankesa është pjesërisht e bazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), vlerësoj se pretendimet e Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), janë pjesërisht të bazuara dhe si të tilla i aprovoj pjesërisht për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë për Rastin 1 paraqesin shkelje të nenit 5 paragrafi 3 të Rregullores Zgjedhore nr.07/2024 ku parashihet se *“Asnjë subjekt i certifikuar nuk mund të angazhojë persona nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç në fushatë zgjedhore. Pjesëmarrja e fëmijëve në fushatë zgjedhore, nuk mund të bëhet pa prezencën apo pëlqimin e*

prindërve”. Ndërsa lidhur me pretendimin ankimore për përshkruar si ne piken 3, 5,6 dhe 9 te ankesës thyerje të heshtjes zgjedhore ne ditën e votimit, Paneli ka konsideruar këtë veprim si shkelje të nenit 37, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, pasi veprimi është bërë gjatë heshtjes zgjedhore e që ka për qëllim ndikimin tek votuesit. Neni 37 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet *.”Nga hapja e Qendrave të Votimit për votim, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre, u ndalohet secili prej veprimeve si më poshtë: 1.2. bërja e fushatës në çfarëdo mënyre”*, e po ashtu edhe nenit 8, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 i Rregullores 07/2024, ku parashihet se *“Nga hapja e Qendrave të Votimit për votim, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre, u ndalohet secili prej veprimeve si më poshtë: 1.5. shfrytëzimi i mediave lokale ose ndërkombëtare dhe rrjeteve sociale me qëllim të ndikimit tek votuesi”*.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: *“vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet në ankesë janë pjesërisht të qëndrueshme dhe si të tilla i pranoi, pasi që me provat e bashkëngjitura në ankesë vërtetohet se gjatë tubimit të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje ka pasur prezencë të fëmijëve nën moshën 15 vjeçare, veprim ky i cili është në kundërshtim me nenin 5 paragrafi 3 të Rregullores nr.07/2024. Po ashtu lidhur me pretendimet si në rastet 3, 5,6 dhe 9, të përshkruara si me lartë në ankesë, Paneli lidhur me provat e prezantuara nga ankuesja gjeti se, afër qendrës së votimit ka qëndruar një makinë me flamur me elemente zgjedhore të subjektit politik LVV. Drin Kastrati në ditën e zgjedhjeve ka postuar fotografi të kandidatit për deputet nga Lëvizja Vetëvendosje, Albert Selishta me shkrimin “Voto 92. Ne rrjetin social Instagram shihet se mbështetësja Anita Ukaj, ditën e zgjedhjeve ka publikuar fotografi të kandidatit nga Lëvizja Vetëvendosje, Albin Kurti. Afrim Gashi në ditën e zgjedhjeve ka publikuar fotografinë e tij duke postuar me shkrimin “Unë votova 116 për SIGURI DHE BEGATI voto edhe ti urime”, Paneli vlerësoj veprimet e tilla përbejnë shkelje të nenit 5 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 të Rregullores nr.07/2024, si dhe shkelje të dispozitave ligjore nenit 37 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, po ashtu fakti Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë ditës së votimit, veprimet e subjekteve politike të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit se nga veprimet e përshkruara në ankesa nga parashtuesit e ankesave paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtat i pranoi si të bazuara.

Ndërsa lidhur me pretendimin në ankesë të përshkruar në piken dy të ankesës se ankuesit kanë vërejtur një postim në të cilën shihet një video e Forcës së Sigurisë së Kosovës, në rrjetin social facebook kandidati për deputet nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje-Ilir Qeriqi, të bërë në ditën e votimit, këto pretendime Paneli i ka refuzuar si të pabazuara pasi e ankuesi nuk e ka precizuar dhe nuk ka dëshmuar me prove se kur është bërë shkelja e pretenduar. Ndërsa lidhur me pretendimin ankimore për përshkruar si ne piken 4, 7, dhe 8 të ankesës për thyerje të heshtjes zgjedhore në ditën e votimit, paneli i ka refuzuar këto pretendime pasi ankuesi nuk ka dëshmuar me prova të qarta këto pretendime se këto shkelje ka ndodhe në

ditën e votimit. Lidhur me këto pretendime, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 par.3 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen në mënyrë decitive thuhet se *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*.

Duke pas parasysh se në këtë vendim janë përfshi disa shkelje, ndërsa lartësia e dënimit i përgjigjet natyrës së shkeljes dhe praktikës së ndjekur nga paneli për raste të tilla. Pra, paneli, me rastin e vendosjes së lartësisë së dënimit si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, dhe për te gjitha shkeljet e lartecekura i shqiptoj shumën e cekur si ne dispozitiv te këtij vendimi.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, si dhe neni 37 paragrafi 1 nen paragrafi 1.2 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZP.Anr.49/2025 më datën 30.12.2025

Kryesues i Panelit
Ramush Bardiqi



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa në kuptim të nenit 118.4 të LZP-së.